



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.09.2018, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Takim pune i Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në Radiotelevizionin Publik Shqiptar në lidhje me veprimtarinë e përditshme dhe ecurinë e procesit të digjitalizimit.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Adelina Rista, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Almira Xhembulla dhe Bujar Çela.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Kejdi Mehmetaj, Shezai Rrokaj dhe Nora Malaj.

Të ftuar:

Thoma Gëllçi – drejtor i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Publik Shqiptar,
Martin Leka – zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Publik Shqiptar,
Henri Muça – drejtor i Njesisë Teknike,
Rezart Aga – drejtor i Njesisë së Programeve,
Bledar Zaganjori – drejtor i Njesisë së Lajmeve dhe Programeve Tematike,
Henri Koci – inxhinier,
Zana Minarolli – përfaqësuese e Arkivit.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëdita të gjithëve!

Thoma Gëllçi – Mirë se erdhët në takim!

Milva Ekonomi – Në fakt, ne kemi ndërmarrë disa angazhime, siç ju e dini, për të zhvilluar aktivitete parlamentare, që lidhen me ndjekjen nga afër të institucioneve të pavarura për veprimtarinë e tyre dhe për të parë si shkon puna e përditshme në lidhje me rezolutat që ka miratuar Kuvendi.

Duke qenë se tashmë jemi të gjithë të njohur me rezolutën për Raportin e veprimtarisë 1-vjeçare të RTSH-së për vitin 2017, që u miratua në vitin 2018, fillimisht do të ishim të interesuar të dëgjonim një përshkrim të detyrave tuaja dhe realizimin e tyre, për të vijuar më pas me pyetje për të kuptuar edhe më mirë se si po shkon procesi i digjitalizimit.

Thoma Gëllçi – E para, dua t’ju falënderoj që erdhët, kërkesë kjo e imja herë pas here që të vinit në RTSH dhe ta shikonit nga afër punën tonë.

Si fillim, dua t’ju njoh me ekipin drejtues të RTSH-së, që janë prezent këtu.

Besoj mua më njihni, por gjithsesi unë jam Thoma Gëllçi, drejtor i Përgjithshëm i TSH-së; Martin Leka, zëvendësdrejtor i Përgjithshëm; Henri Muça, drejtor i Njesisë Teknike; Rezart Aga, drejtor i Njesisë së Programeve, si dhe Bledar Zaganjori, drejtor i Njesisë së Lajmeve dhe Programeve Tematike. Pastaj vijnë organet e tjera poshtë të RTSH-së: teknike, krijuese, administrative e të tjerë.

Pa dashur të zgjatem në terma të përgjithshëm, le të kalojmë në disa gjëra konkrete, që unë do të desha t’i prekja dhe që mund të them se na shqetësojnë.

Pa dashur të zgjatem, sot përmendet shumë fjala “digjitalizim” për RTSH-në, sa herë flitet për procesin e digjitalizimit dhe unë them se është nënkuptuar digjitalizimi i transmetimeve, siç aktualisht po implementohet një projekt nga RTSH-ja, ai i kalimit të transmetimeve tokësore në digjital DVBT-2. Për mendimin tim, ky është një vështirësi i thjeshtëzuar i procesit të digjitalizimit të RTSH-së, sepse ky proces është shumë më kompleks sesa kaq. Ai përfshin digjitalizimin e jashtëm, që është ky që përmenda: ndërtimi i stacioneve dhe kalimi i transmetimeve nga analoge në digjitale, si dhe digjitalizimi i brendshëm, që është edhe më kompleks dhe ka të bëjë me kthimin e të gjithë prodhimit radioteleviziv në digjital, si dhe kthimin e arkivit të RTSH-së në digjital. Pastaj, brenda futet krijimi i rrjeteve, qoftë rrjeteve të IT-së, elektrike e të tjerë. Shkurtimisht po raportoj se tani kemi vënë në punë 54 site të transmetimeve digjitale. Po ta shikoni hartën që kam këtu, me ngjyrë jeshile janë shënuar të

gjitha stacionet tona, që transmetojnë anembanë Shqipërisë dhe projekti mund të quhet pothuajse i mbaruar, por jo plotësisht, sepse kemi edhe 4 stacione transmetuese, të cilat nuk i kemi vënë ende në punë. Njëri është stacioni në Sarandë, i cili do të vihet në punë pas 2 javësh, sa të plotësohen dy gjëra të vogla.

Po ashtu, është stacioni i Llogarasë për të cilin kemi kërkuar ndihmën e qeverisë për të shtrirë një linjë elektrike në malin e Llogarasë, sepse atje nuk ka energji elektrike. Është stacioni i Hadërajt në Treblovë të Vlorës, i cili nuk është vënë në punë, sepse i mungon energjia elektrike, por atë besoj se do ta mbyllim vetë brenda javës. Ky stacion është me rëndësi, sepse bën mbylljen e unazës së Jugut dhe sigurojmë garanci të plotë për transmetimet në Jug të vendit. Po ashtu, është edhe stacioni i Llogarasë për të cilin kemi disa vështirësi për ta vënë në punë.

Kemi edhe stacionin e Krujës, që është pjesë e *allotment*-it të Tiranës, i cili gjatë punës do të dalë gati i panevojshëm për t'u ngritur, sepse Tirana mbulohet shumë mirë me sinjal. Do të shikojmë propozimin e kompanisë gjermane, se çfarë do të bëjmë me këtë stacion. Ndoshta do ta vëmë në disa zona, ku është më i nevojshëm dhe ku nuk ka mbulim të mirë, si, për shembull, në Berat, mbrapa kalasë.

Sot me kënaqësi të madhe ju them se nga puna e njësisë teknike janë ndezur dhe, sidomos në prag të kampionatit botëror, u vunë në punë gati të gjitha stacionet transmetuese të rrjetit tonë DVBT-2.

Nuk dua t'i përmend të gjitha këto arritje, të cilat janë shumë të mëdha për ne. Kuptohet se vënia në punë e stacioneve transmetuese (përveç këtyre 40 stacioneve, që ishin pjesë e projektit DVBT-2), kishim edhe 11 të tjera, që quheshin stacione ekzistuese të RTSH-së, të cilat nuk ishin përfshirë as në projekt dhe as në kredinë e marrë nga RTSH-ja, ka qenë një periudhë vështirë. Na u desh që brenda një viti të rregullonim dhe riparonim 11 stacione, të quajtura ekzistuese, por që në fakt nuk ekzistonin, gati-gati u bënë të reja, duke filluar nga ai në Fushë-Dajç, për të mbaruar në Mile, Gllavë, Çervetakë, Petresh dhe disa vende të tjera që nuk i kujtoj për momentin. Kjo ka kërkuar investime shtesë shumë të mëdha nga ana e RTSH-së. Vetëm për rinovimin e këtyre stacioneve, shtrimin me linja elektrike, vendosjen e transformatorëve të rinj dhe gjëra të tjera, që janë bërë për të bërë të përshtatshme kullat për transmetimet e reja digjitale, mund të jenë harxhuar rreth 2 milionë euro shtesë të paparashikuara, të cilat janë hequr nga fondi i RTSH-së të dedikuara për gjëra të tjera. Për shembull, tani duhet të kishim autobusë *HD* dhe studio *HD*, por nuk i kemi, sepse i devijuaam fondet në një gjë tjetër, vetëm e vetëm që të mbarohej projekti i transmetimeve ...

Gjithashtu, projekti ka defekte të projektimit, që duken gjëra të vogla, por që krijojnë shqetësime shumë të mëdha te shikuesit. Për shembull, në Durrës, në qoftë se të gjitha stacionet televizive i kanë drejtuar antenat nga e njëjta anë, antena e RTSH-së është në anën e kundërt. Do të thotë që nëse një qytetar durrsak do që të ndjekë RTSH-në, duhet që ta kthejë antenën nga ana tjetër dhe të mos shikojë stacionet e tjera. Po kështu ndodh edhe në Lezhë. Të gjitha stacionet janë te Tyrbja e Lezhës, kurse RTSH-ja nuk u lejua të ngrinte stacion atje me arsyetimin se është *site* arkeologjik. Ne i respektojmë rregullat e shtetit për *site*-n arkeologjik, kurse shteti nuk ndërhyr për stacionet e tjera private, duke i lënë ato të vazhdojnë transmetimin nga Tyrbja. Ndërkohë, një qytetar i Lezhës duhet ta kthejë mbrapsht antenën, në mënyrë që të shikojë RTSH-në. Kjo e ul ndjeshëm shikueshmërinë. Po kështu e kemi edhe në vende të tjera.

Duhet që AMA të diktojë, siç e ka udhëhequr këtë proces, që të gjitha pikat transmetuese për qytetarët të jenë në të njëjtin vend dhe drejtim, dhe të mos kthehet antena sa majtas djathtas. Gjithashtu, gjatë projektit nuk është marrë parasysh që kjo po bëhet në Shqipëri, por është marrë parasysh sikur po bëhet në Gjermani dhe projekti është ndërtuar pa depozita karburanti, gjë që e bën sistemin shumë vulnerabël. Ne e dimë që nuk ka tension të mjaftueshëm në qytet, jo më në majë të maleve, ku fryn erë, bie dëborë, ikin vazhdimisht dritat dhe duhet punë me gjeneratorë vazhdimisht. Unë po ju them se stacioni i Leskovikut ka një depozitë të planifikuar 20-25 litra dhe për të dërguar një makinë që të mbushim stacionin e Leskovikut, duhet të harxhojmë 70-100 litra benzinë, në mënyrë që të hedhim 25 litra karburant. Deri sot kemi vënë 10 depozita me nga 1000 litra dhe kemi tenderuar 11 pika të rëndësishme të transmetimit për të krijuar depozita 3300 litërshe në majë të maleve, kur nuk kemi akses në dimër, të cilat duhen vënë nën tokë, në mënyrë që të mbrohen nga vjedhjet. Këto të gjitha janë fonde, të cilat janë hequr padrejtësisht nga taksa e qytetarëve të destinuar për filma më të mirë, programe më të mirë, për teknologji më të mirë.

Paralelisht me këtë ne vazhdojmë me transmetimet analoge. Këtu në Tiranë RTSH-ja ka qenë gati për kalimin e tranzicionit nga analog në digjital që më 1 dhjetor të vitit 2016 dhe që nga kjo periudhë RTSH-ja duhet të merrte para nga muksi i dytë, që është i destinuar të mbajë televizionet private lokale në muksin e dytë të RTSH-së. Por meqë është shtyrë procesi i fikjes, RTSH-ja është detyruar të mbajë ndezur muksin e dytë dhe të mos marrë para, sepse ata vazhdojnë transmetimet në analog dhe në transmetime pirate digjitale, të cilat AMA i fiku javën e fundit, por që deri dje kanë punuar.

Pjesa më e madhe e popullsisë, sidomos në Tiranë, shikon në analog dhe nuk është e pajisur dhe e përshtatur me teknologjinë e duhur marrëse për transmetime DVB-T2 analog ose

DBT. Një pjesë e madhe e ka DBT, por në përgjithësi fshati e ka analog. Ky është një shqetësim që e kam ngritur të paktën një 50 herë, qoftë në Komisionin e Medies, qoftë në Komisionin Ekonomisë, qoftë me memo Kryeministrit, qeverisë së Shqipërisë dhe parlamentit. Si do të bëhet kjo punë? Nuk u parashikua që efekti do të ishte kaq i madh, siç ndodhi, dhe u kthym përsëri mbrapsht në transmetimet analoge. Se çfarë do të bëhet pas 15 janarit, unë nuk e di. Ndërkohë, ne kemi përgatitur një dekoder tonin të RTSH-së, por përsëri ai është një gjë shitet, sepse ka kosto. Ne nuk mund t'i falim popullit dekodera, sepse nuk na lejon njeri.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

88 mijë i ka falur qeveria e Shqipërisë.

Gjatë kësaj periudhe kalimi transmetimi nga analog në digjital, kemi për detyrë të mbajmë në këmbë transmetimet analoge, sepse tjetri kërkon të ketë transmetimin analog dhe është rritur dukshëm përmirësimi i transmetimeve analoge, si në Vlorë, në Tropojë dhe në Has, ku kemi instaluar transmetues të rinj, apo në Korçë, që më pas u fikën. Të gjitha këto janë para të investuara në një drejtim të gabuar, që nesër këto do të fiken, sepse jemi gati në DVB-T2. Ne investojmë përsëri para në rrjetin analog të Tiranës, sepse Tirana duhet të ketë transmetime analoge. Ne jemi gati prej 2 vjetësh e ca në transmetime numerike, prandaj ky është problem i madh.

Gjithashtu, kemi probleme me transmetuesit e radios.

Aktualisht, kemi tri radio, "Radio 1", "Radio 2" dhe "Radio 3" që është "Radio Klasik", të cilat janë kombëtare. Normalisht transmetohen vetëm me një radio në rang kombëtar, sepse nuk kemi rrjete të transmetimeve në dy radiot e tjera," Radio Tirana 2" dhe "Radio Klasik". Ato dëgjohen vetëm në një zonë të ngushtë të Tiranës, Fierit, ku kap një antenë nga Dajti.

Gjithashtu, radiot janë të shpërndara dhe kanë nevojë për investime shtesë për mbulimin mirë të rrugëve, sepse më parë, kur është bërë radioja, nuk kishte shumë interferenca, nuk kishte shumë radio dhe pajisjet ishin të reja, ndërsa sot duhen investime shtesë për radion, kështu që për vitin e ardhshëm kemi planifikuar, dhe po përcaktojmë preventivat përkatës, ndryshimin e transmetimeve në FM, nga sistemi një transmetues/një antenë në tre apo katër transmetues/një antenë, pra duke i përmbledhur, sepse kjo na kursen edhe investimet në energjinë elektrike.

Problem i madh janë edhe transmetimet DVB-T2. Shpenzimet që ka RTSH-ja, i ka nga buxheti i saj: 3,5 milionë euro është kredia, 2,2 milionë euro SLA-ja dhe mbi 2 milionë euro energji elektrike, mirëmbajtje, roje etj. Domethënë, nga 15 milionë euro që ka buxhetin vjetor RTSH-ja, pjesa më e madhe e buxhetit kalon për shërbime teknike, të cilat nuk të lejojnë mundësi, as për politikë të mirë pagash, se pjesa tjetër është paga dhe sigurime shoqërore, dhe

as për investime të tjera teknologjike, sepse pjesa më e rëndësishme e digjitalizimit të RTSH-së është digjitalizimi i brendshëm. Dy vjet më parë RTSH-ja ka pasur prapambetje të theksuar, mungesë të investimeve teknologjike dhe pa një pikësynim të qartë se ku do të arrihej në digjitalizimin e brendshëm. Kjo kërkonte zëvendësimin e të gjitha kamerave të studiove. Kemi 21 kamera studiosh, të cilat ishin të gjitha CD, *standard defenition*, të gjitha në formatin 4 me 3, të papërshtatshme për transmetimet e sotme, të cilat duhet të zëvendësohen me kamera HD dhe në formatin e transmetimeve 16 me 9. Sot pak me të blerë, pak me mjete rrethore, si dhe duke i zëvendësuar lart e poshtë, të 21 kamerat e studios i kemi HD dhe jemi pak krenarë që e kemi bërë këtë gjë. Ndërrimi i kamerave duhet të shoqërohet edhe me ndërrimin e të gjithë infrastrukturës, duke përfshirë mikserët, regjitë deri edhe te kabllot. Kemi bërë investime, por u kemi rënë në qafë programeve. Pavarësisht rritjes së numrit të kanaleve, që me të gjitha kanalet tona lokale janë 13 kanale, fondi i programeve është i njëjtë si me një kanal. Një pjesë të madhe të fondit të programeve e merr e drejta televizive, blerja e të drejtave sportive, filmave, serialëve e të tjera, dhe prodhimi i brendshëm është për faqe të zezë.

Në qoftë se do të kërkojmë cilësi, ne duhet të investojmë në programe, por s'mund të investojmë në programe pa bërë këtë ndryshim, sepse s'mund t'i japësh popullit një figurë të shformuar, siç ndodhte dikur, që zgjerohej figura e dilnin të tëra spikeret tona të shëndosha, dhe thoshin ku i keni gjetur këto të shëndosha, sepse nga formati 3 me 4, i çonim 6 me 9, duke e zgjeruar figurën në ekran.

Tjetër që kam për të shtuar është përmirësimi i rrjetit IT dhe elektrik, që sot këtu nuk ekziston.

Do të flas pak më tepër për një problem të rëndësishëm që është arkivi i RTSH-së.

Arkivi ka dy elemente:

- kthimi në digjital i arkivit të vjetër i periudhës qysh kur filloi transmetimi radioteleviziv;

- arkivimi i ri, prodhimi i ri digjital i RTSH-së.

Për këtë do të bëj prezantimin e një sistemi të menaxhimit të medias në RTSH. Ky është një hap revolucionar në sistemin e menaxhimit të medias. Nuk e ka asnjë media tjetër në Shqipëri. Ne jemi përpara dhe mendojmë se kur të implementohet plotësisht, do të ndryshojë jo vetëm pamjet e RTSH-së si organizim të medias, por do të ndryshojë edhe metodën e punës.

Ndërkohë, do të kisha dëshirë të shihnim një film të shkurtër rreth arkivit tonë.

(Fillon shfaqja e dokumentarit mbi gjendjen e Arkivës.)

Është një nga arkivat më të pasur të vendit, në një gjendje të mjeruar.

Rregullimi i ambienteve dhe digjitalizimi i lëndës arkivore kërkon një periudhë kohe jo më pak se 10 vjet dhe një fond jo më pak se 15 milionë euro. Por kjo është pjesa për ta shpëtuar, ndërsa pjesa për ta vënë në punë, është tjetër gjë. Për këtë të fundit do të flasë zoti...

Nuk do të mërzhiteni pak që të shikoni gjendjen e arkivit, meqenëse keni ardhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Unë e kuptoj të gjithën se çfarë është.

Thoma Gëllçi - Ju thoni t'i bëjnë të bukura nga jashtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Skedarët janë.

Ky është arkivi i fonotekës së Radios, janë disqet.

Fidel Ylli - Kjo është vlerë kombëtare dhe të ikë kjo, është tmerri më i madh.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Sa para duhen për t'i arkivuar?

Thoma Gëllçi - Sapo jua thashë, 10 vjet punë dhe 15 milionë euro.

Milva Ekonomi – Ndërkohë, a punoni me donatorët? Nuk është ai programi i arkivimit nga qeveria zviceriane që ka punuar me Shqipërinë?

Thoma Gëllçi – Asnjëri nuk jep para për këtë. Duke pritur donatorët, ka mbetur kështu. Prandaj ne kemi marrë masat, kemi ndërtuar infrastrukturën e duhur për digjitalizimin e Arkivit, mund të bëjmë edhe një vizitë atje, dhe kemi filluar hap pas hapi me digjitalizimin e tij. Po dixhitalizojmë betat, kemi rregulluar 4 të tilla, që i kemi në gjendje shumë të mirë, do të rregullojmë edhe 4 të tjera dhe vitin tjetër do të marrim, do të blejmë skaner dhe do të fillojmë me filmin. Duke pritur donatorët, ky ka mbetur në këtë gjendje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Po për situatën konkrete, është marrë ndonjë masë për mbrojtjen nga zjarri dhe nga lagështia?

Thoma Gëllçi - Ne nuk kemi para të bëjmë investime.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj - Edhe për mbrojtësit nga brejtësit?

Thoma Gëllçi – Vetëm ato bëjmë, që t'i mbrojmë, që të mos prishen. Kemi ndërruar kondicionerët, temperatura...

Tani duhet të rregullojmë ambientet e brendshme. Kemi parashikuar që të blejmë kasa plastike dhe të zëvendësojmë kasat e ndryshkura metalike të filmit, se ndryshku u bën dëm, që të ruhen, por nuk është kjo zgjidhja.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Ka ndonjë vlerësim, sa metra janë?

Thoma Gëllçi - Janë të shkruara të gjitha. Janë më shumë, por sipas formateve...

Milva Ekonomi – Një makineri sa bën në 8 orë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Thoma Gëllçi – Sa është filmi, sa orë, *real time*. Sa ecën filmi, aq.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Unë kam njëzet e shtatë mijë kilometra, dua njëzet e shtatë mijë orë.

Këto kthehen në orë. Sa pajisje dhe sa njerëz duhen?...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Henri Muça – Nuk është vetëm kjo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Nuk merret dot me qira?...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Thoma Gëllçi – Ku do ta marrësh me qira?

Milva Ekonomi – Në Maqedoni, për shembull.

Thoma Gëllçi – Ku ka me qira në Maqedoni?

Milva Ekonomi – Po pyes, pra! Po bëj pyetje.

Thoma Gëllçi – S'ka asgjëkundi.

Milva Ekonomi – Unë po të bëj pyetje. A mund të merret me qira?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Aparaturën, e marrim dot me qira?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Henri Muça – Ka disa kompani që vijnë dhe e bëjnë këtë punë, por vlerësimi i fundit fare nga një kompani, e cila ka disa vite që merret me këtë, ishte 12 milionë euro.

Milva Ekonomi – Domethënë aty-aty është.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Thoma Gëllçi – Dhe pa bërë gjëra të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më duket se zoti Ulqini ka qenë prezent në një bisedë që kemi bërë me kompaninë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ato janë përralla me mbret, për mendimin tim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani është arkivi elektronik.

Henri Muça – Që është shirit.

Thoma Gëllçi – Shirit magnetik, që janë pajisjet *beta*, *betacam*, *ampex*. Për këto *ampex*-et s'ka pajisje gjëkund.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Henri Muça – Janë më të vështira për t'u gjetur, por janë edhe më të shtrenjta.

Fidel Ylli – Po, a ka ndonjë mënyrë përshtatjeje?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të përshtaten?

Henri Muça – Ka akoma në treg. Por, po të krahasosh sa ishin para pesë vjetësh dhe sa janë tani, tani janë trefishuar. Pas pesë vjetësh mund të dhjetëfishohen, e hajde gjeji.

Fidel Ylli – Po si t'i kthejmë këto, që t'i bëjmë digjitale?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po s'bëmë atë, jemi të mbaruar.

Milva Ekonomi – Sa punonjës keni? Sa është numri i punonjësve të Arkivit?

Thoma Gëllçi – Dyzet.

Milva Ekonomi – A mos duhet shtuar numri i punonjësve të arkivit?

Thoma Gëllçi – Mendojmë t'i shtojmë, pasi të nisim këtë projektin që kemi.

Henri Muça – Po ne do të shtojmë vetëm *hed*-in. Domethënë, do të hapim asetet e do të marrim...

Thoma Gëllçi – Do ta shikoni procesin që kemi nisur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Henri Muça – Më pas, arkivi bën edhe zbardhjen e materialit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo është punë akoma më e madhe se ajo tjetra.

Milva Ekonomi – Ka një skedë për këtë gjë. Ajo skeda që pamë në letër duhet hedhur atje.

Henri Muça – Ajo skeda thotë: shiriti në metrin 35 është Drejtori i Përgjithshëm, filani.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ndërkohë, kur ai e bën nja dhjetë orë atë pjesën, në orën e njëmbëdhjetë a e shpejton ritmin, sepse normalisht?...

Thoma Gëllçi – Si ta shpejtojë?

Milva Ekonomi – E shpejton, sepse batuta që bën ti në një rast...

Thoma Gëllçi – Jo, jo, një sekondë!

Milva Ekonomi – Më fal! Sa herë shtyp gishtin kështu, në të gjithë botën tregon se ka një kufi, minimalisht, që ti bën tre në orë, dhe pasi ke bërë shtatë orë pune, kjo shkon tridhjetë në orë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Thoma Gëllçi – Kur të shtypë butonin? Po ai është shiriti që do të shkojë...

Milva Ekonomi – Por, ndërkohë, ka nevojë edhe për këtë pjesën, që është kohë konsumuese. Prandaj po pyes, a është bërë diçka për të parë fondin e punonjësve që duhen për këtë?

Thoma Gëllçi – Duhet makina.

Henri Koçi – Ne e kemi bërë një matje, prandaj thamë 10 vjet.

Thoma Gëllçi – Duhet makina.

Milva Ekonomi - Po, pra. Nuk ka ndonjë mundësi për ta ulur këtë kohë, sepse problemi...?

Henri Muça – Duke blerë nga 2 makina, 4 makina dhe nga 4 makina, 8 makina, çdo gjë përgjysmohet...

Fidel Ylli – Të jemi më konkretë. Duhet të sensibilizohet opinioni publik dhe qeveria të nxjerrë një buxhet apo do të rrimë në dorë të donatorëve? Se kjo është një ndërhyrje që nuk pret. Ne rrimë dhe bëjmë fantazira sa të duash... Vjen një drejtor, ikën, vjen një tjetër, ikën dhe arkivi rrënohet. Çfarë do të bëjmë që të ngremë zërin?

Thoma Gëllçi – Më fal, Fidel!

Pikërisht këtë nuk kemi bërë deri tani, që të rrimë në dorë të donatorëve. Unë, së bashku me dy deputetë, shkuam deri në Bruksel, me donatorë të Bashkimit Europian... Me gjëra të bukura, kot së koti, nuk ecin ata. Nuk është ecur asnjëherë kështu.

Ka një shembull. Sllovenia ka ecur përpara dhe këshilla e saj ishte: “Mos u ngatërroni me këta lart e poshtë, por bëjeni siç e kemi bërë ne.”

Fidel Ylli – Si e kanë bërë ata?

Thoma Gëllçi – Vetë.

“Fillojeni avash-avash. Çdo ditë vonesë është në dëm të punës”. Ne e kemi filluar këtë gjë avash-avash. Do ta shpejtojmë, po të kemi më tepër para, por e kemi filluar. Si e filluam? Në radhë të pare, krijuam infrastrukturën ku do të shkojë ky arkiv, sepse ne kemi deri tani 10-15 arkiva. Lajmet kanë arkiv më vete, programacioni ka arkiv më vete, digjitale po flasim.

Para disa kohësh, një *hard disk*, i cili mbante rreth 5 apo 10 vjet punë, pati një defekt dhe mund të fshihej komplet puna e bërë. Arritëm ta rikuperonim dhe e kemi në gjendje pune sot, por duhej ndërtuar kjo që do t'ju çoj ta shikoni, infrastruktura e duhur për të bërë arkivin dhe *media ascent management*, *softwar*-ët e duhur për të punuar me arkivin, që ky arkiv të jetë i përdorshëm për transmetime, se arkivi thjesht kthehej në digjital, pa e kataloguar... Është e kotë ta mbash...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...sepse ashtu mjafton t'i rregullojmë kondicionimin, t'i rregullojmë kushtet, ta lëmë aty për bukuri dhe të themi: "Arkivin e kemi të sigurt." Nëse nuk bëhet si duhet, është e kotë të bëhet.

Unë po them se Arkivi i filmit ka digjitalizur filmin shqiptar dhe e ka digjitalizuar në atë mënyrë, që sot është e nevojshme të digjitalizohet përsëri, sepse është bërë keq, për arsye se ashtu ka qenë teknologjia me telekinematë. Kjo tani nuk vlen, sepse kur shfaqet filmi në ekran, aty dalin disa njolla. Prandaj, para dy vjetësh RTSH-ja me fondet e saj, duke u rënë pak më qafë edhe programeve, filloi një projekt. Në fillim ne kemi bërë disa studime, më pas tenderuam pjesën e parë, që është ngritja e *data center*-it dhe blerja e *software*-ve të menaxhimit të medias.

Aktualisht sot jemi në fazën e blerjes të 160 licencave të menaxhimit të medias, në mënyrë që çdo punonjës i RTSH-së, sipas sektorëve të caktuar, të merret me këtë punë dhe jo thjesht 40 punonjësit e Arkivit, pasi edhe ata kanë punën e tyre në zbardhje. Më vonë ne mund të blejmë edhe licenca të tjera, por njerëzit duhet të mësohen dalëngadalë. Kjo gjë rrit transmetimin dhe prodhimin, sepse ne sot kemi një kanal, që është "Shqip" në *full automatization*, që transmetohet me këtë sistem dhe deri në fund të vitit mendojmë të kalojmë në *full automatization* edhe tri kanale të tjera. Gjithashtu, kemi menduar se si do të mbahet arkivi fizik, jo më me *hard disk*, por me *disaster recovery*, në mënyrë që nëse ndodh diçka...

(Diskutime pa mikrofon.)

Dua t'ia kaloj fjalën një prej inxhinierëve me të rinj të RTSH-së, zotit Henri Koçi.

(Diskutime pa mikrofon.)

Për shembull, nëse qeveria na jep një fond të dedikuar, të paktën 1 milion euro për arkivin, do të ishte një gjë shumë e mirë. Jam i bindur se kur Arkivi të bëhet në rregull, do të nxjerrë lekët e tij.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Ta dëgjojmë pak djalin, sepse është një proces për të cilin ne jemi krenarë që po e realizojmë. Nuk është bërë në asnjë televizion tjetër dhe mendojmë se do të ecim shumë mirë. Kjo do të ndryshoj dhe mënyrën se si do të punohet.

Henri Koçi – Ne kemi blerë një sistem *hetero*, i cili është një sistem për menaxhimin e aseteve multimediale. Pra, me arkivimin e aseteve, nuk është më e rëndësishme të kalohet audio dhe video në një mjedis digjital, por, përveç kësaj, duhet të hidhet edhe skedari i digjitalizuar, duhet bërë zbardhja, sepse duhet të dimë se çfarë po arkivojmë. Një pjesë e rëndësishme e arkivimit është edhe zbardhja e gjithë materialit që po arkivojmë. Ne e kemi filluar këtë proces dhe kemi blerë një sistem, i cili, përveç arkivimit në mënyrë digjitale, ka edhe një *workflow* pune, pra ka një proces që merret që me hedhjen e materialit në hardisk digjital dhe deri në daljen në transmetimin e tij.

Fidel Ylli – E keni atë skemë?

Henri Koçi – Po.

Fidel Ylli – Është skemë pak e komplikuar.

Henri Koçi – Këtu shpjegohet *workflow* i sistemit, të cilin mendojmë që vitin tjetër ta nisim me automatizimin e *news room*-it, i cili fillon me kryeredaktorin, që ndan punët për çdo gazetar në temat e ditës, kjo në formë digjitale. Gazetari sjell materialin digjital, të cilin e ka gjysmë të përgatitur, sepse e di se ku do ta nisë, bën zbardhjen dhe e çon te montazhi i duhur, kështu matet edhe efienca në punë e çdo punonjësi, pra sa montazhe ka bërë kjo pikë dhe sa punë ka bërë çdo gazetar, sepse gjithsecili do të ketë *user*-in e vet dhe do të tregojë punën e vet. Pra, të gjitha do të jenë në një *workflow* të dedikuar për çdo lloj materiali. Për shembull, një material që vjen me titra ndjek *workflow*-in për të bërë titra, një që vjen për dublim ka *workflow*-in e vet, një që blihet nga jashtë gati përzgjidhet si aset dhe përzgjidhen njerëzit e duhur për të bërë punën e duhur.

Çdo sektor ka edhe menaxhimin e mbikëqyrjen, pra shefi i redaktorëve kontrollon punën e redaktorëve dhe jep lejen për transmetim, shefja e përkthyesëve kontrollon punën e përkthyesëve dhe jep lejen për transmetim.

Milva Ekonomi – A keni filluar trajnimin e stafit për këtë program?

Henri Koçi – Po. Ne kemi nisur me një kanal dhe e kemi në transmetim me këtë program sot.

Milva Ekonomi – Pra, stafi që po punon është i trajnuar për punën?

Henri Koçi – Po, trajnuesit kanë filluar të trajnojnë të tjerët.

Kjo është një skemë se si funksionon një *workflow*, çdo kuadrat është një proces, çdo proces njoftohet me *email* ose telefon.

A mund të shpjegoj etapat?

Milva Ekonomi – Po, shpjegoi etapat.

Henri Koçi – Me krijimin e një asemi, automatikisht gjenerohet një *email*, i cili u shkon personave që do të merren nga fillimi deri në fund me procedimin e këtij asemi. Pra, që nga etapa e parë, dikush që hap një aset, për shembull, kryeredaktori i një kanali të caktuar, i cili do të hedhë një material të ri në arkivin e vet, kur krijon këtë aset ai gjeneron automatikisht një *email*, i cili u shkon disa sektorëve që do të marrin përsipër pjesën e ankimimeve deri në përfundim të transmetimit të këtij asemi.

Milva Ekonomi – Pra, ajo që kuptohet tani është se që nga momenti që është blerë pajisja, RTSH-ja ka sistemin e vet informativ, të cilin nuk e ka pasur më përpara, ka qenë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Henri Muça – Kjo është diçka tjetër. Është sistemi informativ, por jo sistemi i brendshëm. Ky është një sistem i menaxhimit të medias që i shërben prodhimit televiziv, arkivimit dhe transmetimit.

Fidel Ylli – Çfarë ishte kjo, ishte risi e blerë diku që u përshtat këtu? Ka të bëjë me teknologjinë apo me burimet njerëzore?

Henri Muça – Të gjitha bashkë.

Fidel Ylli – Këtu është thelbi, gjersa qenka e vetmja, cila është kjo shpikje? Është mençuria juaj që e morët dhe e bletë si pajisje...

Thoma Gëllçi – E kemi blerë.

(Diskutime pa mikrofon.)

E gjithë bota me këto punojnë.

Milva Ekonomi – Pak a shumë ashtu siç punojnë edhe bankat që blejnë një program.

Fidel Ylli – Prandaj po e theksoj është mençuri apo...?

Henri Muça – Të bësh skemën duhet që çdo sektor të bëjë punën e duhur, ta trajnosh dhe ta bëjë ashtu siç duhet.

Ne jemi në hapat e parë. Deri tani kemi rreth 27 licenca pune, pra 27 persona punojnë me këtë. Ndërsa tani jemi në procesin e blerjes së 170 licencave dhe puna do të fillojë në masë, si dhe blerjes së tri licencave *play out*, të tre kanaleve të tjera.

Milva Ekonomi – Sa programe si puna e kësaj ka në botë?

Henri Muça - Mund të ketë 10, mund të ketë...

Milva Ekonomi – Ju e zgjodhët duke e bërë me njerëz, pra duke u futur Rezari, Bledari, ti e të tjerë?...

(Diskutime pa mikrofon.)

E kuptuat vetë nevojën.

(Diskutime pa mikrofon.)

Henri Muça – Pra, ta lëmë skemën dhe të kalojmë në një aset të caktuar thjesht për ta parë procesin direkt, sepse skema në këtë mënyrë, nuk duket dhe të zë koka kur e shikon.

Kjo gjë angazhon tërë sistemin, edhe marketingun. Për shembull, kur jepet një reklamë, kjo reklamë sapo transmetohet gjeneron një faturë që e merr llogaritari. Ose kur mund të transmetosh një film dy herë, nuk të jepet e drejta ta transmetosh për herë të tretë, sepse të thotë se ai film ka dalë nga të drejtat. Në një rast tjetër, kur ka një film me pullë të kuqe, i cili nuk është i përshtatshëm për t’u transmetuar në këtë orë të caktuar, kjo gjë caktohet që në fillim, kur është hapur, madje ka edhe censurë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Henri Koçi - Të matet koha e reklamave aq sa të lejon AMA. Pra, është një sistem i ndërtuar posaçërisht për medien, i cili po implementohet.

Milva Ekonomi – A ka ndonjë entuziazëm te këta 27 përdorues? A janë entuziastë ata?

Henri Muça – Njëri prej këtyre përdoruesve është i pranishëm.

(Diskutime pa mikrofon.)

Zana Minarolli – Unë quhem Zana Minarolli dhe jam redaktore e arkivit. Ne si redaktorë, aktualisht jemi 8, po punojmë për programin e ri. Çfarë ndryshimi ka programi i ri me programin që kemi pasur?

Emisioni vjen komplet me video dhe audio dhe ne si arkivë kemi për detyrë ta zbardhim. Zbardhja na lejon që programin ta bëjmë fragment më fragment, duke u marrë me çdo gjë, si me intervistat, sinkronat apo pamjet. Pra, çdo gjë do të jetë e ...

(Diskutime pa mikrofon.)

Thoma Gëllçi – Të shikojmë konkretisht..

Zana Minarolli - Pjesa që kemi ne si arkiv ka nga më të ndryshmet... Tiranën, pamje nga lartë, nga më të ndryshmet dhe ne mund t’i nxjerrim në mënyrë të atillë dhe programi na lejon me metodën e kërkimit që të shkruajmë vetëm “Tirana”...

Henri Muça – Kjo do t’u shërbejë shumë lajmeve...

Thoma Gëllçi – Golat me kokë, dhe bën një kronikë për golat me kokë.

Henri Muça – Lajmin e shpejtë, në qoftë se duhet nga arkivi e krijon këtu. Për 10 pamjet që kemi marrë në 10 rastet e një mbledhjeje...

Thoma Gëllçi – Edhe ruhet, sepse prodhohet në disa formate, një format që është për transmetim, një format që është format i vogël në fund, që hap kompjuterin...

Henri Muça - Kontrolli i cilësisë është një nga proceset...

Milva Ekonomi – Domethënë paska dy procese të mëdha, një i jashtë dhe një i brendshmi.

Thoma Gëllçi – Ky i brendshmi nuk bie në sy, por është më i rëndësishmi dhe më i vështiri, sepse nuk është i mbështetur financiarisht. Për atë të jashtëm u morr një kredi prej 21 milionë euro, i paguam qeverisë edhe 4 milionë euro TVSH që të realizonte planin, 26 milionë euro shkoi në total.

Milva Ekonomi – Patentën e kanë italianët.

Henri Muça - Kjo nuk është patentë. Ngaqë këta kanë punuar me RAI-n dhe na vijnë shumë për shtat duke qenë publik me publik, sepse këto të gjitha janë halli i publikut, pjesa e kontrollit të njerëzve që në privat, zakonisht ia lë njerit dhe e bën ai, ose dy njerëzit e tu.

Henri Koçi – Në lidhje me këtë program, ne kemi hedhur një pjesë të vogël për faktin që aktualisht e kishim dixhitalizuar dhe menaxhimi i tyre bëhet nëpërmjet programit. Siç mund të shohim, aty janë të renditura të gjitha materialet që kemi...nuk shihet rezolucioni...

(Diskutim i disa personave njëherësh.)

Thoma Gëllçi - A do shkojmë në vend të shikojmë Arkivën?

Milva Ekonomi –Procedoni si ta gjykoni, sepse ne jemi këtu për të na thënë çfarë ju keni shqetësim, që të kuptojmë se si po shkon Radiotelevizioni Publik.

Thoma Gëllçi - Që para dy vjetësh kemi nxjerrë jashtë përdorimit një pjesë të madhe të materialeve që nuk bënin dhe kemi dy vjet me radhë, që nuk po bëjmë dot një proces të nxjerrjes jashtë përdorimit. Aq rregulla ka, sa...

Henri Muça - Të mos flasim për blerjen e konjunkturës që duhet shpejt... se televizion është, ndodh...

Thoma Gëllçi – Po ju tregoj një rast që flet shumë: u dogj transformatori ynë në **Milenë** dhe duhej ndërruar. Pyeta kolegët se sa bën një transformator, ndërkohë ne po punonim me gjenerator. Më thanë se bën 10 milionë lekë të vjetër. Duhet ta blinim me urgjencë, se gjeneratori harxhon shumë më tepër. Bëmë një procedurë të përshpejtuar në Agjencinë e Prokurimit Publik, por ata na e kthyen mbrapsht, sepse duhej të ishte parashikuar. U bënë ankesa, shkoi puna 6 muaj, ndërkohë energjia dhe nafta që harxhohej ishte sa për të blerë 7

transformatorë. Sipas ligjit, drejtorit të Përgjithshëm i jepet e drejta të firmosë pa pyetur askënd për 1% të buxhetit; për shembull, mund të blejë 200 mijë euro pa pyetur asnjëri, por nuk i lejohet të blejë një transformator.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Henri Muça - Na bien gomat e makinës gjatë rrugës dhe jemi të detyruar t'i blejmë me lekë në dorë vetë. Kjo është çështje ligjesh.

Thoma Gëllçi - RTSH-ja nuk është ndërmarrje. Drejtori i Përgjithshëm e ka me ligj, mund të firmosë për blerje 200 milionë euro, por nuk i lejohet të blejë një gomë makine kur ajo shpohet rrugës.

Milva Ekonomi- Qenka për të bërë statistikë sa herë shpohen rrotat e makinës!

Në bazë të kësaj, është i rëndësishëm menaxhimi financiar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fadil Nasufi - Kjo ndodh për shkak të procedurës së tenderimit apo për mungesë fondesh?

Thoma Gëllçi - Për procedurë.

Besnik Baraj – A mund t'ju ndihmojmë ne?

Fidel Ylli – Pra, ke të drejtë të firmosësh 200 mijë euro për një program, por nuk merr dot 200 mijë lekë një gomë, është nonsense!

Milva Ekonomi - Mund të bëhet që për çështje emergjence Këshilli Drejtues i RTSH-së miraton deri në 10% të buxhetit, pra të ketë një limit.

Thoma Gëllçi – Tani do të shkojmë t'i shohim konkretisht disa gjëra.

Komisioni vijon me vizitën e tij në ambientet e RTSH-së.

MBYLLET MBLEDHJA

